

V E N D I M
Nr.425, datë 20.5.1996

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PRODHIMIN, INSTALIMIN DHE
SHFRYTËZIMIN E REZERVUARËVE TË GAZIT TË LËNGËZUAR TË NAFTËS”**

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Të miratojë rregulloren për prodhimin, instalimin dhe shfrytëzimin e rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës”, që i bashkangjitet këtij vendimi.

2. Në nenin 23 të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr.11, datë 21.11.1977, ndryshuar me vendimin nr.142, datë 4.5.1985, nga pajisjet nën presion, përjashtohen rezervuarët e gazit të lëngëzuar të naftës dhe tubacionet e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi